


**PLANI PËR TRAJNIM  
I NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2014**



[WWW.ZELS.ORG.MK](http://WWW.ZELS.ORG.MK)  
[CONTACT@ZELS.ORG.MK](mailto:CONTACT@ZELS.ORG.MK)

JANAR, 2014

## HYRJE

Bashkësia e njërive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë – BNJVL, duke u ballafaquar me sfidën për dizajnim të ndërtimit të kapaciteteve të funksionerëve të zgjedhur në nivel lokal dhe të administratës komunale, kurse në drejtim të ofrimit të nevojave të vërteta, cilësore dhe përkatëse të komunave zbatoi një sërë trajnimesh, rezultati i të cilave është kjo kornizë e kurikulumeve për trajnim.

Duke i ndjekur ndryshimet e reja dhe nevojat e komunave u hartua propozim kornizë për trajnim për vitin 2014. E njehta është dërguar deri te 14 rrjetet profesionale të BNJVL-së: urbanizëm dhe ndërtimtari, financa, arsim, efikasitet energjetik, teknologji informatike, mjedis jetësor, resurse njerëzore, zhvillim ekonomik lokal, rojtarë komunalë, zjarrfikës, juristë, marrëdhënie me publikun, eurointegritime dhe komunikacion.

**Pas konsultimeve me përfaqësuesit e administratës profesionale komunale doli Plani vjetor për trajnime për vitin 2013, që përbëhet prej 13 lëmenjesh dhe gjithsej 25 njësi tematike.**

Çdo lëmi profesionale i përmban elementet në vijim:

- 0 – Karakteristika të përgjithshme
- 1 – Grupe qëllimore(GQ)
- 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimi
- 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimit
- 4 – Kohëzgjatje
- (5 – Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

Elementet nën pikat 0, 1, 2 janë pjesë hyrëse të çdo lëmie. Elementet nën pikat 3, 4 dhe 5 janë pjesë specifike të çdo moduli që e përbëjnë lëminë e dhënë.

## ELEMENTET E PËRBASHKËTA

### 1. PROGRAMI DITOR

Në pajtim me kërkesat e administratës komunale programi DITOR është rekomanduar të konceptohet konform elementeve në vijim:

- Një ditë pune e trajnimit do të zgjasë 6 orë (me pauza të përfshira prej një ore e gjysëm gjithsej)
- Një ditë nga pjesa e punës së trajnimit do të ndahet në 4 seanca – dy seanca me nga 60 minuta dhe dy seanca me nga 45 minuta
- Në fillim të çdo trajnimi 30 minuta do t'i përkushtohen Hyrjes në trajnim (10 minuta) dhe detektimit të diturisë Hyrëse të pjesëmarrësve (20 minuta)
- Në fund të çdo trajnimi 30 minuta do t'i përkushtohen Evaluimit të trajnimit (10 minuta) dhe detektimit të diturisë Dalëse të pjesëmarrësve (20 minuta)
- Një trajnim do të zgjasë së shumti dy ditë.

Vëmendje: Një periudhë të caktuar pas përfundimit të trajnimit do të kryhet kontroll i zbatimit të diturisë nga ana e pjesëmarrësve dhe atë në njërin prej mënyrave në vijim:

- Dërgimi i pyetësorëve – për pjesëmarrësit dhe udhëheqësit e drejtpërdrejtë të tyre ose varësisht nga grupi synues edhe deri te kryetarët e komunave;
- Pyetësorët mund të ndahen në mënyrë elektronike ose të kryhen nëpërmjet telefonit.
- Në kuadër të vizitave të komunave.

## 2. METODOLOGJIA E TRAJNIMIT

### A. Metodat e rekomanduara për mësim:

- Puna në grupe
- Shembuj praktikë
- Punëtori
- Shkëmbim i përvojave
- Vizita të punës
- Mësim interaktiv

### B. Teknika aktive të mëimit dhe të dërgesës së trajnimit do të zbatohen dhe atë:

- Mësim
- Ushtrime
- Studim i rastit
- Diskutim
- Pyetje dhe përgjigje

### C. Materiale të paketit për trajnim

- Pyetje hyrëse dhe dalëse për kontroll të diturisë
- Prezantime
- Materiale kryesore për ushtrim
- Lista e materialeve plotësuese
- Formularë evaluativë

*Materialet do të distribuohen falas me postë elektronike.*

## I. URBANIZËM

### o – Karakteristikat e përgjithshme

Në kuadër të nivelit kryesor parashikohen trajnime për Ligjin për ndërtim, Ligjin për tokë ndërtimore, si dhe ligje kryesore mbi të cilat bazohet puna në lëminë e planifikimit urbanistik. Niveli kryesor i trajnimeve do t'u ndihmonte të punësuarve në sektorët/departamentet për planifikim urbanistik, lidhur me kompetencat, të drejtat dhe obligimet, udhëheqjen e procedurave në lëminë.

Në kuadër të nivelit të mesëm parashikohen trajnime për ligjet të cilat konkretisht zbatohen në planifikimin hapësinor, realizimin dhe zbatimin e planeve urbanistike. Niveli i mesëm i trajnimeve ka të bëjë me të gjithë të punësuarit në sektorët/departamentet për urbanizëm, për avancimin e tyre të vazhdueshëm në zbatimin e obligimeve të punës.

### 1 - Grupet qëllimore (GQ)

Udhëheqës dhe të punësuar në sektorët/departamentet për urbanizëm dhe punë komunale dhe sektori për inspeksion në komunat.

Parashikohet që grupet të jenë të përziera, me nga 1-3 përfaqësues nga komunat, për trajnim. Të organizohen në 4 grupe rajonale.

### 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimi

- Avancimi i diturive dhe aftësive të të punësuarve në lëminë e planifikimit urbanistik.
- Procedura të standardizuara dhe të unifikuara në të gjithë lëmenjtë e planifikimit urbanistik, duke i përfshirë edhe inspeksionin ndërtimor dhe urbanistik.
  - Formularë të standardizuar dhe të unifikuar në të gjithë lëmenjtë e planifikimit urbanistik, duke i përfshirë edhe inspeksionin ndërtimor dhe urbanistik.
- Udhëheqja elektronike e procedurave
- Analiza e gjendjeve në komunë si bazë për hartimin e programeve për urbanizëm dhe rregullim të tokës ndërtimore
- Përfshirje e publikit në:
  - Procedurat për miratim të programit vjetor për planifikim urbanistik
  - Procedurat për miratim të programit vjetor për rregullim të tokës ndërtimore.

## U1. Leje për ndërtim

(Trajnimi konform Ligjit për ndërtim dhe vendosja e procedurës për lëshim elektronik të lejeve për ndërtim. Realizimi i modulit do të zbatohet në pajtim me nevojat e komunave dhe avancimin e aplikimit ekzistues softuerik).

### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimit

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Lëshimi elektronik i lejes për ndërtim	→ Hapa në procedurën e lejeve për ndërtim → E-sistem për lëshimin e lejeve për ndërtim Regjistër i lejeve të lëshuara për ndërtim
2	Leje për shfrytëzim	→ Hapa në procedurë → Inspeksion i lejeve të lëshuara për ndërtim
3	Procedura tjera dhe lloje të lejeve	→ Leje për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe pajisjes urbane → Ndërtime për të cilat nuk është e nevojshme leje për ndërtim → Leje për punët përgatitore → Raste të veçanta të ndërtimit → Përdorimi, mirëmbajtja dhe largimi – ridedikimi, adaptimi dhe rikonstruktimi

### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për një grup synues deri 40 pjesëmarrës. Numri i trajnimeve do të varet nga numri i pjesëmarrësve të paraqitur.

(5 – Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

Trajnimi detyrimisht zbatohet me shfrytëzimin e mjeteve nga teknologjia elektronike-informatike. Për shkak të numrit të kufizuar të njësive kompjuterike, numri maksimal i trajnimit është 40 pjesëmarrës.

## U2. Zbatimi i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik

### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimit

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:



	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Plane urbanistike	→ Risi të përcaktuara me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një ditë për të gjithë pjesëmarrësit. Trajnimi mund të jetë pjesë e përbërjes tematike të një evenimenti – këshillim.

(5 – Cilësitë; elemente të shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

### U3. Zbatimi i Ligjit për tokë ndërtimore (Trajnim konform Ligjit për tokë ndërtimore)

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Marrja e autorizimit për udhëheqje të procedurës për tjetërsim dhe dhënie me qira të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë  (trajnimi realizohet në pajtim me nevojat e komunave)	→ Zbatimi i rregullativës ligjore lidhur me tjetërsimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore në pronësi të shtetit → Shfrytëzimi i aplikimit softuerik për e-auksion dhe e-regjistër → Seancë e provimit
2	Trajnim plotësues për zbatimin e Ligjit për tokë ndërtimore	→ Risi të përcaktuara me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tokë ndërtimore → Zbatimi i avancimit të aplikacionit softuerik për e-auksion dhe e-regjistër

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të organizohet konform dispozitave nga Ligji për tokë ndërtimore.

(5 – Cilësitë; elemente të shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

Trajnimi detyrimisht zbatohet me shfrytëzimin e mjeteve të teknologjisë elektronike-informatike. Për shkak të numrit të kufizuar të njësive kompjuterike, numri maksimal për trajnim është 40 pjesëmarrës.

## II. JURISTË

### 0 – Karakteristikat e përgjithshme

Sektorët/departamentet juridike në komunat në formën e tyre organizative më së shpeshti i përfshijnë punët juridike, veprimtaritë me interes publik, punët e përgjithshme, menaxhmentin dhe menaxhimin me resurset njerëzore.

### 1 - Grupet qëllimore (GQ)

Udhëheqësit dhe të punësuarit në sektorët/departamentet, nëpunësit shtetërorë profesionalë, përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike dhe institucionet e themeluara nga NJVL.

### 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimi

Juristët e punësuar vazhdimisht japin shpjegime në kahje të zbatimit të ligjeve dhe dispozitave tjera të kolegëve të tyre dhe bashkëpunëtorëve të cilët drejtpërdrejtë i zbatojnë në punën e përditshme.

### **P1. Qasja e lirë në informacionet me karakter publik**

#### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimit

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	<b>Lënda</b>	<b>Përshkrim i shkurtër</b>
1	Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik	→ Obligime që rrjedhin nga ky Ligj
2	Zbatimi praktik i Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik	→ Ushtrime praktike për obligimet që rrjedhin nga ky Ligj

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për grup rajonal. Gjatë një viti, do të realizohen gjithsej 4 trajnime.

#### (5 – Cilësitë; elemente të shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

Trajnimi u përkushtohet personave të autorizuar nga komunat për qasje të lirë në informacionet me karakter publik.

### P2. Vendosja e sistemit për menaxhim të cilësisë

#### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimit

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Ligj për vendosjen e sistemit për menaxhim me cilësinë	→ Përshkrim i detyrave dhe obligimeve → Kornizë e përbashkët për vlerësimin e punës dhe dhënies së shërbimeve në shërbim shtetëror
1	Vendosja e standardeve dhe instrumenteve për menaxhim me cilësinë	→ Vendosja e së paku standardit kryesor ISO 9001

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë. Gjatë një viti, do të realizohet 1 trajnim.

#### (5 – Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

Trajnimi u përkushtohet anëtarëve të rrjeteve të juristëve dhe resurseve njerëzore.

### P3. Kornizë e përbashkët për vlerësim (CAF)

#### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimit

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Vendosja dhe zbatimi i instrumentit CAF për menaxhimin e cilësisë në komunat duke synuar kah përmirësimi i punës së administratës	→ Krite dhe nënkrite të CAF-it → Përdorimi i modelit të CAF-it → Kahje për zbatimin e CAF-it → Roli i sistemit për vlerësim



#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë. Gjatë një viti, do të realizohet 1 trajnim.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

Trajnimi u përkushtohet anëtarëve të rrjeteve të juristëve dhe resurseve njerëzore.

### III. FINANCA

#### o –Karakteristikat e përgjithshme

Vendosja e sistemit adekuat për financim të NJVL-së është një ndër shtyllat kryesore në procesin e decentralizimit dhe në përgjithësi në reformën e sistemit të vetëqeverisjes lokale. Me miratimin e rregullativës së re ligjore u krijuan parakushte për ndërtim të sistemit të financimit objektiv, transparent, të qëndrueshëm dhe të drejtë. Mjaft e rëndësishme është vendosja e baraspeshës adekuate ndërmjet madhësisë së komunës, fuqisë së saj ekonomike dhe kapaciteteve të përgjithshme nga njëra anë dhe vëllimi i kompetencave që i kryen, nga ana tjetër.

#### 1 - Grupet qëllimore (GQ)

Të punësuarit financiarë në komuna, udhëheqësit, kryetarët e komunave, këshilltarët.

#### 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimit

Zbatimi adekuat i rregullativave ligjore në lëminë e financimit, si dhe menaxhimi i tyre-planifikimi, kryerja, mënyra e financimit dhe analiza e rezultateve, në masë të madhe e cakton funksionimin e përgjithshëm të NJVL-së. Duke u nisur nga ky drejtim, ndërtimi i kapaciteteve të komunave në lëminë e financave është i domosdoshëm.

#### **F1. Arkëtimi dhe kontrolli i tatimeve lokale (tatimi mbi pronën)**

##### a– Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimit

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Të drejtat dhe kompetencat e trajtuara me tatimin mbi pronën konform Ligjit	→ Në dispozitat ligjore ka zgjidhje të paqarta ose joadekuate, sqarimi gjatë marrjes së vendimeve adekuate konform Ligjit për tatime mbi pronën, iniciativë për ndryshime

		dhe plotësime
2	Tatime mbi pronën	<p>→ Harmonizim i vlerës së përcaktuar të pronës së patundshme me vlerë të tregut të pronës së patundshme konform Metodologjisë për vlerësim të vlerës së tregut</p> <p>→ Procedura për ndjekjen e vazhdueshme (azhurim) të ndryshimit të vlerës së tregut të pronave të patundshme në pikëpamje të rinovimit, mbindërtimit, ndërtimit, pronë e re e patundshme dhe ndryshime të tjera të vlerës.</p> <p>→ Hartimi i procedurave për ndjekjen nga parashtrimi i kërkesës për lejen për ndërtim deri te marrja e lejes për përdorim dhe evidentimi i tyre në bazën e të dhënave për tatimin mbi pronën.</p>
3	Të ardhura nga pronësia Arkëtimi i tatimit të të ardhurave nga prona (e ardhur nga qiraja)	<p>→ Evidencë për pronën e patundshme, bazë e të dhënave</p> <p>→ Kontrolli i shfrytëzimit të pronës së evidentuar në kategorinë pronë në të cilën jetohe</p>
4	Metoda për arkëtim	→ Procedura për pagesë të të ardhurave nga tatimet

#### 4-Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për grup rajonal. Janë planifikuar më së shumti 2 trajnime.

(5 = Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

(6

## F2. Arkëtimi dhe kontrolli i taksave lokale dhe kompensimeve

a – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimit

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Taksat komunale-tatimi i firmës	→ Tatimi i firmës

	etj	<p>→ Shfrytëzimi i muzikës në taksat lokale, taksat turistike, kompenzimet për koncesione, baret e natës, taksat për shfrytëzimin e hapësirës para objektit afarist, mënyrat e kontrollit të të ardhurave nga sigurimi i automjeteve motorike përmes kompanive të sigurimit, kontrolli i të ardhurave nga kompenzimi i taksës komunale nga regjistrimi i automjeteve, kompenzimi nga ndriçimi publik etj.</p> <p>→ Procedura për miratimin e dokumentit përkatës juridik për marrje borxh, evidencë efikase të kërkesës, efikasitet në pagesë, të drejtat dhe obligimet.</p>
2	Mundësitë për të ardhura tjera	<p>→ Ndriçimi rrugor, taksë për buajtje, për higjienë publike, nga taksa për shfrytëzimin e rrugëve, për kryerjen e kontrolleve teknike, për kasko sigurim përmes kompanive për sigurim, kompenzime për koncesione etj.</p>
3	Metoda për pagesë	<p>→ Procedura për pagesën e të ardhurave nga kompenzimet dhe të dhënat tjera, zbulimi i suksesshëm i të gjitha burimeve, evidentimi i tyre, marrja borxh dhe kontrolli i pagesës.</p>
4	Kontrolli	<p>→ Për kontroll efikas të të ardhurave të cilat i mbledhin persona tjerë juridikë ndërsa janë të ardhur e buxheteve të komunave.</p>

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do zgjasë 1 ditë për një grup rajonal. Gjatë një viti do të realizohet trajnim për gjithsej 2 grupe rajonale.

(5 – Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)  
Inspektorë tatimorë

#### IV. RESURSET NJERËZORE

##### 0 – Karakteristikat e përgjithshme

Menaxhimi me marrëdhëniet e punës, të definuara në rregullativën ligjore, si dhe vendosja e sistemit që pastaj nënkupton funksionimin e një mjedisi punues, kërkon edhe formimin e rregullimit relativisht të ri të marrëdhënieve profesionale në lëminë e resurseve njerëzore.

##### 1 – Grupe qëllimore (GQ)

Të punësuarit në NJVL të obliguar për resurse njerëzore, udhëheqësit e departamenteve/sectorëve.

##### 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimit

Aktet e hartuara mirë, para se gjithash në mënyrë të drejtë dhe ligjore do të mundësojnë departament më efikas, më pak ankesa të vendimeve dhe më pak humbje të kontesteve gjyqësore dhe shpenzime, pjesërisht edhe personat për marrëdhënie me publikun në NJVL.

#### **RNJ1. Menaxhimi i resurseve njerëzore në administratën lokale**

##### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimit

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	<b>Lënda</b>	<b>Përshkrim i shkurtër</b>
1	Menaxhimi i resurseve njerëzore	→ Standarde dhe baza për menaxhimin e resurseve njerëzore → Planifikimi strategjik i resurseve njerëzore
4	Procedura për punësimin e nëpunësve shtetërorë dhe të tjerë	→ Rekrutimi → Përzgjedhja → Mbajtja e të punësuarve → Zhvillimi i karrierës dhe avancimi i të punësuarve → Sistemi për vlerësim efektiv → Përgjegjësia disiplinore

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për një grup rajonal. Gjatë një viti, do të realizohen gjithsej 2 trajnime.

(5 - Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

### **RNJ2. Zbatimi i Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për nëpunësit administrativ**

#### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimit

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	<b>Lënda</b>	<b>Përshkrim i shkurtër</b>
1	Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për nëpunësit administrativ	→ Zbatimi i risive konform Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për nëpunësit administrativ të miratuara në vitin 2014.

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për një grup rajonal. Gjatë një viti, do të realizohen gjithsej 2 trajnime.

(5 – Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

## **V. ZJARRFIKËSI**

#### o – Karakteristikat e përgjithshme

Për shkak të shuarjes së zjarreve, shpëtimit të jetës së qytetarëve dhe mbrojtja e pronave të rrezikuara nga zjarret dhe eksplozionet, dhënia e ndihmës teknike gjatë fatkeqësive dhe situatave të rrezikshme, si dhe kryerja e punëve tjera gjatë fatkeqësive formohen njësi zjarrfikëse.

Që të kryhen të gjitha këto punë për të cilat është formuar NJZFT, të punësuarit duhet të kryejnë edhe trajnim të caktuar. Aftësimi profesional dhe avancimi i të punësuarve në NJZFT duhet të realizohet sipas programit të caktuar.



## 1 – Grupet synuese(GQ)

Komandirët e NJZFT në Republikën e Maqedonisë dhe përfaqësuesit e NJZFT-së.

## 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimi

Trajnimi i të punësuarve në NJZFT duhet të realizohet në këto lëmenj:

- Dispozitat nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri,
- Preventiva zjarrfikëse,
- Menaxhimi i NJZFT-së.

Trajnimi është i nevojshëm edhe për shkak të funksionimit normal të NJZFT-së, si dhe për shkak të punësimit të zjarrfikësve të rinj për të cilët nuk është organizuar trajnim i parashikuar konform Ligjit për zjarrfikës.

### **ZF1. Dispozitat nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri**

## 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimeve

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	<b>Lënda</b>	<b>Përshkrim i shkurtër</b>
1	Ligje nga lëmia e NJZFT-së	→ Ligji për zjarrfikësi → Punësimi i zjarrfikësve, nga pikëpamja e kualifikimit të nevojshëm

## 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë.

(5 - Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

## **VI. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN**

### o – Karakteristikat e përgjithshme

Informacioni është shërbim bazik për çdo procedurë nën kompetencën e komunave. Lidhja ndërmjet administratës komunale dhe qytetarëve në bashkësi duhet të vendoset përmes komunikimit të vendosur strategjik, si formë e preventivës në situata të krizës në komunikim me qytetarët ose eventualisht keqkuptimit të rolit, funksionit dhe punës së vetëqeverisjes lokale.

Nën nocionin “marrëdhënie me publikun” në komunat e Maqedonisë fshihet diapazon i gjërë i aktiviteteve, të cilat e përfshijnë komunikimin me bashkësinë në tërësi.

Parimi i transparencës dhe së vetëqeverisjes lokale drejt qytetarëve – shfrytëzues të shërbimeve, e vendos nevojën për zhvillim të formave specifike të marrëdhënieve me publikun.

### 1 – Grupet qëllimore (GQ)

Për shkak të ndikimit të komunikimit me publikun mbi efikasitetin, efektivitetin dhe rejtingun e komunës në bashkësinë lokale është e domosdoshme që krahas PR personave profesionalë në komunë të sigurohen edhe për personat nga radhët e nëpunësve shtetërorë si dhe nëpunësit shtetërorë profesionalë dhe profesionalë administrativ të cilët punojnë në (servis) qendrat shërbyese qytetare ose shërbime të tjera të hapura për komunikim me qytetarët. Përfshirja e personave të obliguar ose të autorizuar për lëminë e marrëdhënieve me publikun në komunat të (pa) përfshira në rrjet, udhëheqësit, të punësuarit në resurset njerëzore dhe kryetarët e komunave.

### 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimi

Trajnimet e specializuara për PR personat nga komunat janë të domosdoshme për përforcimin e kapaciteteve të këtyre personave dhe avancimin e diturive dhe aftësive. PR personat do të kenë mundësi të marrin dituri dhe aftësi të reja në lëmenjtë specifike nga sfera e marrëdhënieve me publikun të cilat janë trend në botë dhe në vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

### **PR 1. Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun**

### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e trajnimit

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	<b>Lënda</b>	<b>Përshkrim i shkurtër</b>
1	Llojet e komunikimit	<ul style="list-style-type: none"><li>→ Komunikim me mediat e shtypit</li><li>→ Komunikim me mediat elektronike</li><li>→ Komunikim nëpërmjet mediave sociale</li><li>→ Komunikim me grupe qëllimore specifike</li><li>→ Komunikim nëpërmjet internetit</li><li>→ Shfrytëzimi i TI-së në komunikimin e protokollit</li></ul>

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për një grup rajonal. Gjatë një viti do të realizohen trajnime për gjithsej dy grupe rajonale.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)  
Sigurimi i mjeteve për teknologjinë informatike/elektronike

### **PR 2. Niveli dhe nevoja e zbatimit të etikës në marrëdhëniet me publikun**

#### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	<b>Lënda</b>	<b>Përshkrim i shkurtër</b>
1	Rregullativa ligjore	→ Etikë dhe komunikim me publikun → Rregullativa ligjore e RM-së
2	Ligji për mediat	→ Zbatimi i Ligjit të ri të mediave në lidhje me obligimet e PR personave në komunat

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për një grup rajonal. Gjatë një viti do të mbahen trajnime për gjithsej 2 grupe rajonale.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

## **VII. MJEDISI JETËSOR**

### o – Karakteristikat e përgjithshme

Duke e ndjekur trendin botëror dhe obligimet që rrjedhin për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian, u sollën një sërë ligje dhe akte nënligjore, me qëllim që të mbrohet mjedisi jetësor. Në procedurën për implementimin e rregullativës ligjore për mbrojtjen e mjedisit jetësor, obligim kanë edhe njësitë e vetëqeverisjes lokale për zbatimin e kompetencave që dalin nga rregullativa ligjore në territorin e vetë. Duke marrë parasysh se zbatimi i suksesshëm i kompetencave që dalin nga rregullativa ligjore, është detektuar nevoja për organizimin e një sërë trajnimeve me qëllim që të zbatohen me sukses dispozitat në pajtim me rregullativën ligjore.

## 1 – Grupet qëllimore (GQ)

Të punësuarit në NJVL, kompetentë për mjedis jetësor dhe veprimtari komunale, si dhe inspektorë. Nëpunës shtetërorë–këshilltarë dhe inspektorë, udhëheqës të departamenteve/sectorëve.

## 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimit

Lidhur me të lartpërmendurën është bërë analizë e rregullativës ligjore për mbrojtjen e mjedisit jetësor me qëllim që të detektohen kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale, ndërsa me këtë edhe domosdoshmëria për organizimin e trajnimeve nga ana e administratës komunale. Në bazë të analizës së realizuar, gjegjësisht nga kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale, të cilat rrjedhin për zbatimin e rregullativës ligjore për mbrojtjen e mjedisit jetësor, është detektuar domosdoshmëria për zbatimin e trajnimeve të përmendura më poshtë.

### **MJ 1. Zbatimi i dispozitave ligjore për menaxhim me mbeturinat nga pajisja elektronike dhe elektrike dhe ujërat e zeza**

## 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	<b>Lënda</b>	<b>Përshkrim i shkurtër</b>
1	Ligji për menaxhim me mbeturinat	<ul style="list-style-type: none"><li>→ Menaxhimi rajonal i integruar me mbeturinat (ndryshime dhe plotësime të Ligjit për menaxhim me mbeturinat)</li><li>→ Përgatitja e programeve vjetore për menaxhim me mbeturinat</li><li>→ Metodologji për formimin dhe pranimin e çmimit për mbledhjen, transportin dhe heqjen e mbeturinave</li></ul>
2	Menaxhimi me pajisje elektronike dhe pajisje elektrike të mbeturinave	<ul style="list-style-type: none"><li>→ Zbatimi i Ligjit për menaxhim me pajisje elektrike dhe elektronike të mbeturinave</li><li>→ Rregullore për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për shkak të moslëshimit të lejes, gjegjësisht mossjelljes së vendimit për refuzimin e kërkesës për lëshimin e lejes për veprim me pajisjen e mbeturinave</li></ul>



3	Ligji për ujëra	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Ujërat e zeza, leje për ujë dhe e drejta për ujë,</li> <li>→ Përpilimi i programeve për mbrojtjen nga veprimtaria e dëmshme të ujërave dhe plane operative për mbrojtje dhe mbrojtja nga përmytjet</li> </ul>
---	-----------------	--

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për një grup rajonal. Gjatë një viti do të mbahen trajnime për gjithsej 2 grupe rajonale.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

### **MJ 2. Lëshimi elektronik i B-PIKN lejeve dhe elaboreve**

#### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Lëshimi elektronik i B-PIKN lejeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Udhëheqja e procedurës elektronike</li> <li>→ E-ndjekja e B-PIKN lejes së lëshuar</li> <li>→ E-regjistër i B-PIKN lejeve</li> </ul>
2	Lëshimi elektronik i elaboreve për mbrojtjen e mjedisit jetësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Udhëheqja e procedurës elektronike</li> <li>→ E-ndjekja e elaboreve të lëshuara</li> <li>→ E-regjistër i elaboreve</li> </ul>
3	Dispozita ligjore për mjedisin jetësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Procedurë për transferim të B-PIKN lejes së lëshuar për përputhje me planin operativ në B-PIKN leje</li> <li>→ Inspektim në zbatimin e Planit operativ të B-PIKN lejes</li> </ul>

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për një grup deri në 40 pjesëmarrës. Numri i trajnimeve do të varet nga numri i pjesëmarrësve të paraqitur.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)



Trajnimi detyrimisht realizohet me shfrytëzimin e mjeteve nga teknologjia elektronike informatike. Për shkak të numrit të kufizuar të njësive kompjuterike, numri maksimal për trajnim është 40 pjesëmarrës.

### **MJ 3. Procedura juridike në lëminë e mjedisit jetësor dhe monitorimit dhe obligimi për matjen e emitimeve në mjedisin jetësor**

#### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	<b>Lënda</b>	<b>Përshkrim i shkurtër</b>
1	Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurë juridike	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Komisioni për vendimmarrje në procedurën juridike</li> <li>→ Risi në pajtim me ndryshimet e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese</li> <li>→ Procedura juridike në lidhje me ligjet nga lëmia e mbrojtjes së mjedisit jetësor</li> </ul>
2	Kadastru elektronik i ndotësve	→ Zbatimi i aplikacionit softuerik
3	Mbikëqyrje dhe obligim për matjen e emitimeve në mjedisin jetësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Laboratore të akredituara</li> <li>→ Veprues të lëshencuar me mbeturina</li> </ul>

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për një grup deri në 40 pjesëmarrës. Numri i trajnimeve do të varet nga numri i pjesëmarrësve të paraqitur.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

Trajnimi detyrimisht realizohet me shfrytëzimin e mjeteve nga teknologjia elektronike informatike. Për shkak të numrit të kufizuar të njësive kompjuterike numri maksimal për trajnim është 40 pjesëmarrës.

### **VIII. ARSIMI**

#### o – Karakteristikat e përgjithshme

Procesi i decentralizimit përfshiu ndryshime dhe plotësime në Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm, në Ligjin për inspektion arsimor u parashikuan dispozita për vendosjen e

inspektorëve arsimorë komunalë të autorizuar, ndërsa në sistematizimin e vendeve të punës në një numër më të madh të komunave u parashikuan vende pune për këshilltarët për arsim, si të pavarur ose të përfshirë në sektorë, seksione ose forma të tjera të angazhimit të punës.

### 1 – Grupet qëllimore (GQ)

Të punësuarit arsimorë në NJVL dhe inspektorët arsimorë, udhëheqësit e departamenteve/sektorëve, kuadri mësimor në shkollat fillore dhe të mesme. Module të caktuara janë edhe në interes të personave për marrëdhënie me publikun edhe për resurse njerëzore në NJVL.

### 2 - Qëllimet dhe lëndët e mësimi

Zbatimi i organizuar i identifikimit të nevojës së trajnimeve për personat përgjegjës për arsim dhe inspektorët arsimorë komunalë është prioritet, me qëllim që të përforcohen kapacitetet e këtyre personave në tejkalimin e vështirësive, me të cilat ballafaqohen në punën e përditshme, veçanërisht në pjesën e cila deri më tani nuk ka qenë e mbuluar me trajnime, si dhe për këshilltarët e sapopunësuar dhe inspektorët komunalë në lëminë e arsimit.

Trajnimet janë parashikuar për personat përgjegjës për arsim dhe inspektorët komunalë arsimor në të gjitha komunat, janë palë të tanguara në zhvillimin e mëtejshëm të decentralizimit në arsim.

#### **01. Organizimi i mësimdhënies**

### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	<b>Lënda</b>	<b>Përshkrim i shkurtër</b>
1	Organizimi i mësimdhënies	→ Organizimi i mësimdhënies së lëndëve zgjedhore → Aktivitetet e projektit → Orë të lira

### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë. Në vitin 2014 do të realizohet një trajnim.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)  
Për këshilltarët dhe inspektorët arsimorë

## IX. ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL

### o – Karakteristikat e përgjithshme

Vendosja e sistemit efikas të vetëqeverisjes lokale është imperative dhe qëllim për secilin kryetar të administratës komunale, i cili udhëhiqet nga betime të mëdha, respektivisht dëshira që të kënaqë një numër të madh të kërkesave të qytetarëve. Ndërtimi i sistemit të shërbimeve cilësore në pjesën e kompetencave që i kanë komunat në procesin e decentralizimit kërkon shumë dedikim dhe kohë, por edhe shumë përvojë dhe para së gjithash dituri, si një ndër segmentet më të rëndësishme të zhvillimit.

Koncepti i kapitalit njerëzor nuk është relevant vetëm ndaj rritjes së efikasitetit në punën e komunave, por edhe ndaj zhvillimit të përgjithshëm ekonomik në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe standardit të jetës së qytetarëve. Në aspekt të nivelit mikroekonomik, territoret e reja të zhvillimit (new growth theories) tashmë e kategorizojnë progresin teknik dhe orientohen drejt edukimit, hulumtimit dhe zhvillimit (R&D), që paraqet edhe një dëshmi për nevojën e edukimit sistematik dhe trajnimit të atyre që kanë ndikim në zhvillimin ekonomik lokal (ZHEL).

Nevoja e evidentuar, për themelimin e Qendrës së Trajnimeve të BNJVL – së, si logjistike është një segment i rëndësishëm i cili është hapi i parë, por nuk do të thotë se nuk është i mjaftueshëm dhe akoma më e rëndësishmja është se cilat tema dhe lëmi do të përpunohen në edukimin e trajnimit, metodologjinë e punës, qasjen dhe më e vlefshmjia kush do t'a zbatojë atë trajnim, niveli i ditorisë, dedikimi dhe përvoja e edukatorëve.

### 1 – Grupet qëllimore (GQ)

Duke pasur parasysh se komunat në punën e deritanishme tashmë kanë marrë përvojë dhe metode të punës dhe duke mos e nënçmuar ditorinë e administratës, dokumenti përpilon sistem për trajnime.

### 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimi

Qëllimi i këtij dokumenti është të japë një kornizë, në të cilën do të lëvizë programi edukativ i Qendrës së Trajnimeve të BNJVL-së në pjesën e ZHEL-it dhe do të definojë tema dhe përfshirje të trajnimeve. Baza për zgjedhjen e temave të këtij dokumenti janë kompetencat e ZHEL-it konform Ligjit për vetëqeverisje lokale (neni 22) të cilat përfshijnë: planifikimin e ZHEL-it, caktimin e prioriteteve zhvillimore dhe strukturore, zbatimin dhe kryerjen e aktiviteteve lokale ekonomike, përkrahjen e NVM-së, ndërmarrjet në nivel lokal, zhvillimin e rrjetit të institucioneve në nivel lokal dhe promovimin e partneriteteve.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën dokumenti paraqet kompilim të kompletuar të kompetencave ligjore për ZHEL-in, përvoja dhe praktika të deritanishme, nevoja e kërkesa të ardhshme për zhvillimin e një administrate të suksesshme, e cila me sukses do të zbatojë aktivitete dhe projekte nga ZHEL-i, me respektim të përgjithshëm dhe duke mos i prekur kompetencat direkte të institucioneve të tjera qeveritare si ANSH-ja në pjesën e trajnimeve

ose zbatimi i programeve për përkrahje të NVM-së nga ana e Ministrisë për ekonomi, si dhe investime të tjera publike dhe private nën kompetecën e agjensioneve dhe institucioneve të tjera.

## ZHEL 1. Çertifikimi miqësor i biznesit

### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Çertifikimi i komunave biznes-miqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Fitimi i Vulës ndërkombëtare për cilësi për komuna biznes-miqësore</li> <li>→ Qëllimet, procedura dhe zbatimi</li> </ul>

### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për një grup rajonal. Gjatë një viti do të realizohen trajnime në pajtim me interesin e shprehur nga ana e komunave. Një komunë duhet të marrë pjesë me së paku 3 persona dhe së shumti 5 persona.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

## ZHEL 2. Planifikimi strategjik i ZHEL-it dhe Project Cycle Management

### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Procesi i planifikimit të ZHEL-it	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Dokumentet strategjike të ZHEL-it (përpilimi/metodologjia)</li> <li>→ Zbatimi dhe mbikëqyrja mbi zbatimin e planeve strategjike të ZHEL-it</li> <li>→ Roli i zyrave dhe departamenteve të ZHEL-it</li> </ul>
2	Project Cycle Management dhe	→ Financimi i ZHEL-it, modeli tradicional i financimit



modelet e financimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Financimi projektues</li> <li>→ Definimi i modeleve, analizë krahasuese, përparësitë, dobësitë dhe cikli projektues</li> </ul>
----------------------	---

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për dy grupe rajonale. Në vitin 2014 do të realizohen gjithsej 2 trajnime rajonale.

### ZHEL 3. Turizmi dhe potencialet e komunave – rrjetëzimi i komunave

#### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Turizmi dhe potencialet e komunave	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Korniza ligjore për veprimtari turistike dhe hotelierike</li> <li>→ Projekte për përkrahjen e turizmit të drejtuar sipas komunave</li> <li>→ Përputhja e strategjive të komunave me strategjinë kombëtare për zhvillimin e turizmit</li> <li>→ Qendrat turistike informuese</li> <li>→ Evidentimi i trashëgimisë kulturore historike dhe pasuria natyrore në çdo komunë.</li> </ul>

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë. Në vitin 2014 do të realizohet një trajnim.

### ZHEL 4. Investimet lokale dhe shfrytëzimi i potencialeve për zhvillim

#### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Investime të huaja direkte	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Definimi dhe llojet</li> <li>→ Ndikimi mbi ekonominë vendore</li> <li>→ Përvojat e investitorëve</li> </ul>



		<ul style="list-style-type: none"> <li>→ Marketing dhe shërbime për fitimin e projektit</li> <li>→ Shembuj të suksesshëm në Maqedoni</li> </ul>
2	Modele për bashkëpunim me NVM	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ NVM-ja dhe ristrukturimi ekonomik</li> <li>→ NVM-ja dhe qasja deri te financat</li> <li>→ Zhvillim dhe përkrahje në kapacitetet teknologjike të NVM-së</li> <li>→ Partneriteti privat publik</li> <li>→ Shërbimet efikase – Strategjia për zhvillimin e EJM-së 2020</li> </ul>

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për grup rajonal. Në vitin 2014, do të realizohen gjithsej 2 trajnime rajonale.

### X. TRAJNIME PËR TIK-un

#### o – Karakteristikat e përgjithshme

Për shkak të rritjes së vazhdueshme në TIK-un e vetëqeverisjes lokale, si dhe obligimet e reja ligjore që i dedikohen vetëqeverisjes lokale në pjesën e TIK-ut, definohej një numër i caktuar trajnimesh të cilat janë të domosdoshme për administratën në vetëqeverisjen lokale.

#### 1 – Grupet qëllimore (GQ)

Trajnimet e TIK-ut kryesisht i dedikohen personave të TI-së të punësuar në komunat, të cilët faktikisht janë hartuesit kryesorë kur janë në pyetje punët lidhur me teknologjitë informatike të secilës komunë. Megjithatë, duke pasur parasysh se edhe nëpunësit shtetërorë nga vetëqeverisjet lokale çdo ditë në punën e tyre hasen me shfrytëzimin e TIK-ut, grup qëllimor i këtyre trajnimeve do të jenë gjithashtu edhe nëpunësit shtetërorë nga vetëqeverisjet lokale.

#### 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimi

Qëllimi i këtij dokumenti është që të jepet një kornizë, në të cilën do të bazohet programi i trajnimeve i Qendrës së Trajnimeve të BNJVL-së në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të shfrytëzimit të teknologjive të TIK-ut në punën e vetëqeverisjeve lokale. Trajnimet përfshijnë segmente të ndryshme nga fusha e teknologjive të TIK-ut në vetëqeverisjet lokale, mes cilave janë: shfrytëzimi dhe përdorimi i aplikacioneve nga softueri i lirë, shfrytëzimi dhe përdorimi i aplikacioneve të GIS-it, shfrytëzimi dhe përdorimi i bazave të të dhënave, shfrytëzimi dhe përdorimi i serverit, shfrytëzimi dhe përdorimi i JOOMLA-s, shfrytëzimi dhe

përdorimi i aplikacionit Microsoft Windows (nga XP deri në 7), shfrytëzimi dhe përdorimi i aplikacionit Microsoft Office, shfrytëzimi dhe përdorimi i aplikacionit CorelDraw dhe Photoshop, shfrytëzimi dhe përdorimi i aplikacionit Adobe Dreamviewer, trajnime për rregullativa ligjore, trajnime për udhëheqje, analiza dhe modelim, si dhe aplikacione dhe instrumente softuerike të reja.

### **TIK 1. Aplikacionet mobile (telefonike)**

3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	<b>Lënda</b>	<b>Përshkrim i shkurtër</b>
1	Aplikacionet mobile	→ Llojet e aplikacioneve mobile → Mënyra e përdorimit të aplikacioneve mobile

4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për grup rajonal. Gjatë një viti do të realizohet 1 trajnim.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

## **XI. EUROINTEGRIMET DHE SHFRYTËZIMI I FONDEVE TË BE-së.**

o – Karakteristikat e përgjithshme

Integrimi i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian është orientim strategjik edhe i vetëqeverisjes lokale në vend. Të dhënat dhe përvojat e vendeve-anëtare të BE-së japin informacion se 70% nga rregullativat e sjella në nivel të BE-së zbatohen nga ana e autoriteteve lokale dhe rajonale. Plotësisht, shfrytëzimi i fondeve evropiane, të cilat bëhen mekanizëm akoma më i rëndësishëm për zhvillimin e kapaciteteve të shtetit, si dhe tërheqja e tyre nga ana e institucioneve vendase është matës shumë i vlefshëm për gatishmërinë e shtetit për anëtarësi në BE.

1 – Grupet qëllimore (GQ)

Trajnimet për eurointegrimet dhe shfrytëzimi i fondeve të BE-së i dedikohen personave të punësuar në komunat, të cilët janë përgjegjës për përgatitjen e projekteve për nevojat e njësive të vetëqeverisjes lokale.

## 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimi

Qëllimi i këtij dokumenti është që të jepet një kornizë, në të cilën do të bazohet programi për trajnime i Qendrës së Trajnimeve të BNJVL-së në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve programuese të dedikuara drejt zmadhimit të kapacitetit dhe aftësive të komunave për zbatimin e rregullave gjatë aplikimit për projekte të financuara nga BE-ja, si edhe për rregullativën evropiane lidhur me zbatimin e tyre.

### ESHF 1. IPA dhe fonde të tjera të BE-së dhe komunave

## 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Rregullativa e re e IPA-s	→ Risi në rregullimin e IPA Fondeve → Përmbajtja e instrumentit
2	Aplikimi për projekte nga IPA Fondet 1	→ Planifikimi dhe programimi → Dokumentet e duhura
3	Aplikimi për projekte nga IPA Fondet 2 (Bashkëpunim ndërkufitar)	→ Punë në raste
4	Shfrytëzimi i projekteve nga IPA Bashëpunimi ndërkufitar	→ Implementimi i projektit nga IPA Fondet
5	Shqyrtimi i Fondeve të tjera të BE-së	→ Shqyrtimi i programeve të BE-së
		→ Karakteristikat e përbashkëta të programeve
		→ Cikli projektues (shqyrtim)
		→ Shfrytëzimi praktik
		→ Fondet e strukturuar
		→ Fondet kohezive

		→ Të rinjtë në aksion, mësimi i përjetshëm, vëllazërimi e të tjera
--	--	--

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 2 ditë për një grup rajonal. Gjatë një viti do të realizohen trajnime për gjithsej 2 grupe rajonale.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

## **XII. EFIKASITETI ENERGJETIK**

### 0 – Karakteristikat e përgjithshme

Efikasiteti energjetik paraqet një ndër instrumentet kyçe në menaxhimin me ndryshimet klimatike. Përfitimet të cilat shoqëria dhe qytetarët i ndiejnë nga zbatimi i masave janë tejet të mëdha, kursimi i energjisë elektrike, zvogëlimi i ndotjes, kursimi i mjeteve financiare, mjedisi jetësor i mbrojtur për brezat e ardhshëm. Në vitet e kaluara që të arrihej niveli i komunave evropiane në zbatimin e masave për efikasitet energjetik dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor u bënë hapa të rëndësishme, me miratimin e legjislativës së nevojshme ligjore dhe dokumente strategjike. BNJVL-ja miratoi Plan aksional për zhvillimin e politikave të reja dhe promovimin e iniciativave lokale në menaxhimin me ndryshimet klimatike. Në pajtim me masat nga Plani aksional parashikohen edhe trajnime për zbatimin e obligimeve ligjore në pjesën e energjetikës dhe efikasitetit energjetik për vetëqeverisjet lokale.

### 1 - Grupet qëllimore (GQ)

Trajnimet për efikasitetin energjetik për personat e punësuar në komuna, të cilët janë përgjegjës për implementimin e masave ligjore në lëminë e efikasitetit energjetik dhe energjetikës në njësinë e vetëqeverisjes lokale.

### 2 – Qëllimet dhe lëndët e mësimi

Qëllimi i këtij dokumenti është që të japë një kornizë në të cilën do të bazohet programi i trajnimeve i Qendrës së Trajnimeve të BNJVL-së, lidhur me zhvillimin e aktiviteteve të programit të drejtuar ndaj rritjes së kapacitetit dhe aftësive të komunave për zbatimin e masave për efikasitetin energjetik në nivel lokal.

## **EE 1. PROGRAME PËR ZHVILLIMIN E EE-së DHE SHFRYTËZIMI I BURIMEVE RIPËRTËRITËSE TË ENERGJISË**

### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.



Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	Lënda	Përshkrim i shkurtër
1	Programe për zhvillimin e efikasitetit energjetik dhe plane vjetore për efikasitet energjetik	→ Përkrahja e NJVL-së në përforëcimin e kapaciteteve për përkufizimin e procesit të përpunimit të Programeve komunale për zhvillimin e EE-së dhe plane vjetore.
2	Shfrytëzimi i burimeve ripërtëritëse të energjisë së NJVL-së.	→ Përkrahja e komunave për përforëcimin e kapaciteteve për bashkëpunim në lëminë e burimeve ripërtëritëse të energjisë.

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për grup rajonal. Gjatë një viti do të realizohet 1 trajnim.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

### **XIII. PASTËRTIA PUBLIKE**

#### o – Karakteristikat e përgjithshme

Ligji për pastërti publike është një ndër ligjet më të reja, i cili krahas kompetencave të komunave në veprimtaritë komunale i ndan edhe një kategori të punësuarish - rojtarë komunalë të obliguar për kontroll dhe zbatim të Ligjit në teren. Për arsye të etablimit dhe njohjes së rojtarëve komunalë midis qytetarëve, ndërsa mjaft e rëndësishme për bashkëpunim me ta dhe njëkohësisht zbatimi i obligimeve ligjore është dedikuar vëmendje në avancimin e diturisë dhe sistemin e punës së këtij lloji të kategorisë të nëpunësve shtetërorë në komuna.

#### 1 – Grupet qëllimore (GQ)

Trajnimet nga lëmia e pastërtisë publike janë dedikuar për personat e punësuar në komunat - rojtarët komunalë, të cilët janë përgjegjës për implementimin e akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me mirëmbajtjen e pastërtisë publike në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

## 2 – Qëllimet dhe lënda e mësimimit

Qëllimi i këtij dokumenti është të japë kornizë, në të cilën do të bazohet programi për trajnime i Qendrës së trajnimeve të BNJVL-së lidhur me zhvillimin e aktiviteteve programore të drejtuara ndaj rritjes së kapacitetit dhe aftësive të komunave për zbatimin e ligjeve.

### **PP 1. UDHËHEQJA ELEKTRONIKE E PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE**

#### 3 – Lëmenjtë e diturisë dhe përmbajtja indikative e programit.

Ky modul do t'i dedikohet përmbajtjes së mëposhtme të trajnimit:

	<b>Lënda</b>	<b>Përshkrim i shkurtër</b>
1	Ligji për pastërti publike dhe dispozitat kundërvajtëse/penale	→ Prezantimi teorik i dispozitave ligjore me dedikim të veçantë në procedurat juridike edhe dispozitat kundërvajtëse dhe penale
2	Shfrytëzimi i aplikacionit softuerik për udhëheqjen elektronike të procedurës kundërvajtëse	→ Shfrytëzimi praktik i aplikacionit

#### 4 – Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë 1 ditë për një grup rajonal. Gjatë një viti do të realizohen trajnime për gjithsej 2 grupe rajonale.

(5– Cilësitë; elementet e shënuara, të cilat nuk përsëriten në çdo kornizë)

Trajnimi detyrimisht zbatohet me shfrytëzimin e mjeteve nga teknologjia informatike dhe komunikuese. Për shkak të numrit të kufizuar të njësive kompjuterike numri më i madh për trajnim është 30 përfaqësues.